



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM
Nr. 02, datë 24. 01. 2023

**“MBI MIRATIMIN E KRITEREVE TË DHËNIES SË NDIHMËS EKONOMIKE NGA
FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLOK - NDIHMËN EKONOMIKE”**

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 24.01.2023, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenin 30/1 të Ligjit Nr. 57/2019 “Për asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”, neni 21, V.K.M Nr. 597, datë 04.09.2019, kreu IV, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”

VENDOSI:

1. Miratimin e kriterëve për dhënie të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si më poshtë:
 - a. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit.
 - b. Familje me kryefamiljare gra në vështirësi ekonomike dhe sociale.
 - c. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune.
 - d. Familje me shumë fëmijë.
 - e. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë antarë që ndjekin universitetin.
 - f. Familje që kanë në përbërje një ose më shumë antarë me paaftesi/invalide pune.
 - g. Familje që kanë një antar dhe janë të braktisur ose të vetmuar.
2. Dokumentat e aplikuesve të jenë sipas VKM nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
3. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 597 date 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore

Vendimi u miratua me 12 vota Pro, Kundër – s’ka, Apstenim – s’ka

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat

KRYETARË KËSHILLIT BASHKIAK

Edlira SHKËMBI

